

VENDIM
Nr. 431, datë 3.6.2020

PËR PLATFORMËN QENDRORE TË FATURAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 26, të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (në vijim AKSHI) mbi lidhjen dhe paraqitjen e informacionit të lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike në platformën qendrore të faturave.

II. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

2. **“Platforma qendrore e faturave”**, sipas përcaktimit në shkronjën “I”, të nenit 3, të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

3. **“SOAP web services”**, protokoll i bazuar në XML, që ka për qëllim shkëmbimin e informacionit të strukturuar, ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore, nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

4. **“Portali Self-Care”**, ndërfaqja e standardizuar për komunikim, ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore, nëpërmjet rrjetit të sigurt për transferimin elektronik të të dhënave nëpërmjet internetit.

III. AUTORIZIMET DHE DETYRIMET GJATË PËRDORIMIT TË PLATFORMËS QENDRORE TË FATURAVE

5. AKSHI është i ngarkuar për krijimin, zhvillimin, mirëmbajtjen, administrimin dhe menaxhimin e platformës qendrore të faturave.

6. Lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të lidhen dhe të regjistrohen në platformën qendrore të faturave.

7. AKSHI, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike, për qëllime të përdorimit të platformës qendrore të faturave, janë të detyruar të sigurojnë ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve thelbësore për rolin e tyre, në një mënyrë të besueshme dhe profesionale, në përputhje me dokumentacionin dhe specifikimet teknike të shkëmbimit të të dhënave, të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

8. AKSHI, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike, për qëllime të përdorimit të platformës qendrore të faturave, janë të detyruar që, në ofrimin e shërbimeve dhe në komunikim ndërmjet tyre, të vënë në dispozicion të njëri-tjetrit informacionin përkatës që disponojnë, të respektojnë rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave, veçanërisht ato që mbrojnë të dhënat personale dhe përdorin procedurat dhe pajisjet e duhura teknologjike.

IV. ZBATIMI TEKNIK

9. AKSHI, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të sigurojnë zbatimin e legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe mirëmbajtjen e sistemeve të tyre të të dhënave.

10. AKSHI është i detyruar të sigurojë që shërbimet në fushën e platformës qendrore të faturave të jenë në përputhje me specifikimet e rregulluara teknike të shkëmbimit të të dhënave, të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

11. AKSHI, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojë dhe të publikojë në faqet e tyre zyrtare të internetit specifikimet teknike të shkëmbimit të të dhënave,

specifikimin bazë të përdorimit të faturave e dokumentacionet e tjera, si dhe çdo ndryshim të tyre.

V. LIDHJA ME PLATFORMËN QENDRORE TË FATURAVE

12. Aksesimi i platformës qendrore të faturave dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet AKSHI-t, lëshuesit dhe marrësit të faturave elektronike përmes platformës qendrore të faturave, do të jetë përmes shërbimeve të internetit të SOAP, duke përdorur mesazhe ose përmes portalit *Self-Care*.

13. Për qëllim të vendosjes së një lidhjeje me platformën qendrore të faturave, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të përdorin dy mjedise të ndryshme, ku instalohen dhe shërbehen versione identike të platformës qendrore të faturave:

- a) mjedisi provë/test – për qëllimet e trajnimit dhe të verifikimit të programeve; dhe
- b) mjedisi i punës – për shkëmbimin zyrtar të të dhënave elektronike dhe informacionit.

AKSHI i siguron lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike mjediset e provës/testit dhe punës për platformën qendrore të faturave.

14. Kushtet për lidhjen e lëshuesve dhe të marrësve të faturave elektronike me mjedisin e punës të platformës qendrore të faturave janë:

a) kalimi me sukses i skenarëve të testit të detyrueshëm në mjedisin e provës/testit në platformën qendrore të faturave;

b) verifikimi i zgjidhjes *software*-ike.

Vetëm një version i verifikuar dhe i certifikuar i zgjidhjes *software*-ike mund të përdoret në mjedisin e punës. Zgjidhja *software*-ike e certifikuar një herë e lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike në mjedisin e provës/testit mund të përdoret për çdo lidhje të mëtejshme me platformën qendrore të faturave në mjedisin e punës.

c) regjistrimi i lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike në platformën qendrore të faturave.

15. Lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të përdorin certifikata elektronike të lëshuara nga AKSHI për t'u lidhur me platformën qendrore të faturave.

16. Certifikatat elektronike përdoren për të krijuar një lidhje të sigurt me platformën qendrore të faturave, për të identifikuar lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike kur shkëmbehen të dhënat në mënyrë elektronike, si dhe për nënshkrimin elektronik të mesazheve në komunikim, ndërmjet AKSHI-t, lëshuesit dhe marrësit të faturave elektronike. Certifikatat elektronike sigurojnë nëse lidhja është vendosur dhe është në përputhje me specifikimet teknike të shkëmbimit të të dhënave, të përmendura në pikën 11, të këtij vendimi.

17. Lëshuesit dhe marrësit e një fature elektronike që krijojnë lidhje me platformën qendrore të faturave në një mjedis provë/test dhe/ose pune janë të detyruar të zbatojnë specifikimet e duhura, në përputhje me specifikimet teknike të shkëmbimit të të dhënave, të përmendura në pikën 11, të këtij vendimi, të cilat rregullojnë mënyrën dhe kushtet e aksesimit (hyrjes) dhe të përdorimit të mjedisit të provës/testit dhe punës.

VI. ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIM

18. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama